



01/Nr. 1589 /2025
Data : 05.03.2025

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dytë -II- për vitin 2025 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 19.02.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë , Rini dhe Sport), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Bajrush Laçi** (Udhëheqës i Zyrës Ligjore) **Përfaqësuesi i OSB-së, Kujtim Dernjani** (Përfaqësues nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2024.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.
4. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
5. Raporti financiar për vitin 2024 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës janë përfshirë marrëveshje aktivitet, takime, subvencione, projekte të hartuar dhe shumë çështje të tjera me rëndësi. Në këtë raport janë përfshirë aktivitet e zyreve të cilat veprojnë brenda zyrës së kryetarit. Materialin e keni para jush dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- si është gjendja tash a po vepron zyra e prokurimit me email apo si është tu funksionuar.

Sevdi Dernjani thekson:- zyra e prokurimit funksionon siç ka funksionuar gjithmonë për çdo të hënë e kemi bordin e drejtorëve dhe raporton për aktivitetet e punës të cilat janë në kuadër të zyrës së prokurimit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- kuvendi i komunës gjatë vitit 2024 ka planifikuar që t'i mbajë dymbëdhjetë mbledhje. Gjatë vitit 2024 ka mbajtur gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta, një mbledhje solemne dhe atë me rastin e përvjetorit të themelimit të Komunës së Hanit të Elezit, që në këtë mbledhje shpalli qytetarë nderi për gjeneralin z.Kudusi Lame. Mbledhjet e kuvendit vazhdimisht janë monitoruar nga monitoruesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Vlen të theksohet se në bazë të monitorimit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2024 kemi pasur tre vendime dhe rregulloren për taksa komunale për vitin 2025 të kthyera për rishqyrtim, kurse të gjitha vendimet tjera që janë marr në kuvendin e komunës kanë qenë në përputhshmëri me ligjin. Gjithashtu mbledhjet janë monitoruar edhe nga OSBE, përfaqësues të OJQ-ve. Vlen të theksohet se transparenca ka qenë e nivelit mjaft të mirë pasi që mbledhja është thirr me kohë dhe është publikuar me kohë ftesa për mbledhje. Transmetimi i mbledhjeve është bërë drejtë për drejt në Televizionin TV Festina. Bashkëpunimi me kryetarin e komunës dhe me ekzekutivin ka qenë i nivelit shumë të mirë. Mbledhjet e kuvendit të komunës vazhdimisht sipas rregullores së punës ju ka parapari mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa në të cilat mbledhje në shumicën e rasteve jemi dakorduar unanimsisht për pikat e rendit të punës për kuvend. Punën e kuvendit të komunës gjatë këtij viti e ka përcjell një frymë e bashkëpunimit si me pozitën ashtu edhe me opozitën por vlen të theksohet se kuvendi i komunës në vitin 2024 ka miratuar buxhetin për vitin 2025.

Mbledhjet e kuvendit kanë qenë të hapura për publikun por edhe pse vazhdimisht i kemi njoftuar qytetarët për një të drejtë të tyre për pjesëmarrje, kemi pas raste ku qytetarët kanë marr pjesë në mbledhje të kuvendit. Na mbetet për detyrë që në vitin 2025 t'i inkurajojmë qytetarët që të marrin pjesë në punimet e kuvendit. Kuvendi i komunës gjatë vitit 2024 ka miratuar 33 vendime dhe dy plotësime ndryshime të rregullores dhe plotësime ndryshimin e statutit të QKMF-së, që në krahasim me vitin e kaluar kuvendi i komunës ka miratuar 55 vendime dhe 2 rregullore. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- sa i përket raportit të kuvendit të komunës ka qenë një transparencë e madhe dhe punët kanë shkuar mirë. Urojë të shkojnë punët mirë edhe për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kujtim Dernjani thekson:- është plan i unifikuar i cili e përfaqëson regjionin e Gjilanit dhe të Ferizajt . Plani e parashih çështjen e menaxhimit të mbeturinave. Bashkë me planin është edhe vlerësimi strategjikë mjedisorë.

Hyriete Isufi thekson:- përshtypje më bëri plani parafizibilitetit. Çka duhet të bënë komuna për çështjen e ndarjes së mbeturinave sepse në përgjithësi si plan ishte i mirë. Nëse bëhet e përbashkët edhe për ujërat e zeza edhe për mbeturinat e përgjithshme si do të mbetet kompania Pastrimi.

Kujtim Dernjani thekson:-plani është përgatitur prej ekspertëve të fushave të ndryshme prej Gëzimit Gjeran, ekspertëve të Ministrisë së Mjedisit dhe ekspertë nga Shqipëria. Edhe unë e kam vërejtur parafizibilitetin dhe nuk e di se ku kanë dashur me dalë. Prej komunës kërkohet që të shpërndahen kontinjerë komposter nëpër familje për me u ndarë mbeturinat pastaj përcillen te pika e përbashkët që do të përcillet në regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit. Kompania jonë do të vazhdon për shkak se është kompani publike lokale vetëm për komunën tonë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGROUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj informacion ta dijë se kush e ka përpiluar këtë raport për shkak se si është e mundshme për çdo pikë janë rritur shpenzimet me vitin paraprakë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATI MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- për vitin 2024 janë legalizuar shtatë ndërtime pa leje dhe të gjitha janë pajisur me certifikata të legalizimit. Në emër të taksës së legalizimit janë realizuar 626.00 €.

Hyriete Isufi thekson:- a ka shumë objekte që nuk janë legalizuar.

Nexhmedin Daci thekson:- është një regjistër i ndërtimeve pa leje që është nga komisioni i komunës në vitin 2014 dhe në bazë të asaj janë 2050 ndërtime pa leje që do të thotë numri është i madh por bëhet fjalë për ndërtime individuale .

Sherif Berisha thekson:-ne kemi marr si kuvend për lirim nga taksa e disa kategorive kërkoj sqarim se kush është liruar nga taksa.

Nexhmedin Daci thekson:- lirimi nga taksa është për kategoritë e dalura nga lufta dhe për kategoritë sociale dhe nga taksa e legalizimit lirohen të gjitha ndërtimet që janë bërë para vitit 2004.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- janë bartur projektet nga viti 2024 për vitin 2025, kemi projektin e parkut të shkollës fillore “Kështjella e Diturisë” kur do të fillojnë punimet.

Nexhmedin Daci thekson:- projekti është i miratuar dhe mjete financiare kemi pak por do të shikohen mundësitë.

Hyriete Isufi thekson:- janë dëmtuar ulëset të parku “Isa Berisha” është mirë që këtë shqetësim me përcjell në këshillin komunal për siguri që me ndërmarr veprime për me i dënuar ata që i shkaktojnë këto dëme.

Sevdi Dernjani thekson:- fatkeqësisht kjo është niveli i vetëdijes në këtë komunitet dhe me një mënyrë apo tjetrën të gjithë ne që jemi përfaqësues të qytetarëve nuk kishim pasur dëshirë me pasur parkun në atë nivel por fatkeqësisht persona të pa përgjegjshëm e kanë dëmtuar dhe parku është qysh është. Ne e kemi pasur projektin dhe në atë projekt kanë qenë të përfshira edhe kamerat dhe për informacione mund të na jep më shumë drejtori i urbanizmit se pse nuk janë instaluar kamerat dhe pse nuk ka mbikëqyrje të kamerave.

Nexhmedin Daci thekson:- kamerat janë por nuk është kompetencë e jona.

Kryesuesi thekson:- është çështje shqetësuese çështja e dëmtimeve që bëhen te parku por për çështje të kamerave disa e konsiderojnë si të ndaluar me i vendosur kamerat në park për shkak se i cenohet liria qytetarit. Te çështja e sigurisë unë mendoj që të hyrja të paktën me pasur kamerë në mënyrë që të dihet se kush është tu hyrë për shkak se nëse ndodhë ndonjë dëmtim me i shikuar se kush ka lëvizur për së fundi herë. Në këshillin për siguri në bashkësi zyrtari komunal ka diskutuar shumë çështje që është dashur me i diskutuar por tjetër kush është organ kompetent që duhet me u marr me ato çështje.

Sevdi Dernjani thekson:- mbledhjet e KKSB-së mbahen dhe temat që janë me u trajtuar trajtohen. Ne kemi kontratë me kompaninë Pastrimi të cilët e mirëmbajnë parkun dhe përkujdesen për parkun. Ne nuk mund të vendosim siguri në parqe për me i identifikuar personat e papërgjegjshëm që bëjnë dëmtime në park por e vetmja mundësi është përmes kamerave për me mundur me i identifikuar personat e papërgjegjshëm të cilët bëjnë dëmtime në park .

Kryesuesi thekson:- nuk e di sa dëmtime janë bërë në park që është marr dikush edhe intervistuar dhe është dënuar pra lajmërohet rasti dhe nuk merr kush masa, bëhet vjedhja dhe nuk zihet askush. Në lagjen e Meliqve janë bërë vjedhje dhe asnjë rast nuk është identifikuar që do të thotë që është shqetësuese. Ata të cilët janë kompetentë për këtë punë nuk janë duke treguar rezultate.

Sevdi Dernjani thekson:-nuk jemi përgjegjës për çështje të caktuar dhe nëse bëhen dëmtime brenda komunitetit tonë janë organet kompetente që merren me trajtimin e këtyre rasteve dhe në këtë rast është policia që i identifikon i dërgon në gjykatë dhe gjykata merret me çështjen.

Nexhmedin Daci thekson:-policia ka intervenuar disa herë dhe personat të cilët janë zënë kanë qenë të mitur.

Sherif Berisha thekson:- para dy dite ka qarkulluar një video se si janë dëmtuar dhe nuk është hera e parë që janë tu ndodhur këto gjëra dhe duhet të ju bëhen presione organeve përgjegjëse që të fillojnë me dënime. Kërkesë është parashtruar nga organizata e veteranëve për çështjen zyrës dhe nuk kanë marr ende përgjigje.

Sevdi Dernjani thekson:- ka qenë edhe një kërkesë me herët për çështje të zyrë dhe zyrën javë ka lejuar Kryetari i Komunës por tash është kërkesë për me mobiluar zyrën por do të shikohen mundësit për çështjen e realizimit të asaj kërkesë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:43.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

